

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja Suzana Çerkini, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit B. K. nga fshati P. Komuna G., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.445/2015 të datës 24.06.2016, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 20.06.2017, me praninë e Prokurorit të shtetit Hivzi Bajraktari dhe të pandehurit B. K., të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri B. K., i biri i I. dhe nënës Sh., e vajzërisë G., i lindur me *data e lindjes...*, në fshatin P. Komuna G. ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion automekanik-i pa punë, i martuar babë i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me LNJ të RKS, me nr. personal *numri personal...*,

-I-

ËSHTË FAJTOR

Sepse, nga data e pacaktuar e deri me datën 10.05.2015 rreth orës 20:26, në fshatin P. Komuna G., ka përdorur armën gjysmë automatike -20 (e modifikuar), prodhim kinez me nr. serik 10220711, në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, në atë mënyrë që pasi kishte një aheng familjar me armën e lartcekur ka shtënë disa herë në ajër, me ç'rast policia ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe të pandehurit ia konfiskojnë armën e lartcekur,

- me çka ka kryer veprë penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK,

- Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 21, 41,42, 49, 50, 51, 62 par.2.6, 69, 73, 74, 75,76 par.1 nënpar.1.5 të KPRK dhe neneve 248 par.4, 365 të KPP, i shqipton,

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i përcakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **10 (dhjetë) muajsh** i cili nuk do të ekzekutohet, nëse brenda afatit prej **1 (një) viti** nuk do të kryejë vepër të re penale si dhe,

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohen: një armë gjysmë automatike- 20 (e modifikuar), me numër serik 10220711, si dhe një karikator i po kësaj arme, të precizuara në vërtetimin mbi marrjen e përkohshme të sendeve Nr.2015-AG-0346 të datës 10.05.2015,

I pandehuri obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumën prej **30 € (tridhjetë euro)**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

Komfor nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, komfor nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP,

-II-

REFUZOHET AKUZA

Sepse, me datën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin e parë i pandehuri B. K. ka poseduar në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, armën gjysmë automatike-20 (e modifikuar) prodhim kinez me numër serik 10220711,-

- me çka kishte për të kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK,
- Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza,
- Shpenzime të procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.445/2015 me Aktakuzë të datës 24.06.2016, ka akuzuar pandehurin B. K.n, për shkak të dy veprave penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, ka mbajtur shqyrtim fillestar, në të cilin prokurori i shtetit për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK të përshkruar në dispozitivin II të aktakuzës, u tërhoq nga ndjekja penale në kuptim të nenit 52 të KPP, ngase siç ka theksuar kjo vepër penale konsumohet me veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK, të përshkruar në pikën I të aktakuzës. I pandehuri B. K., i vënë në dijeni të plotë për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, vullnetarisht pranoi fajësinë për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK, e cila i vihet në barrë me aktakuzë, për çka ka theksuar se ndihet njëmijë herë i penduar, e din se ka gabuar, thekson se është invalid i luftës dhe se armën e ka siguruar nga koha e luftës në Shqipëri, ndërsa vëllaun e ka pasur të sëmurë në Turqi ndërsa gruaja e tij ka lind djalë, për çka është ndier i gëzuar dhe sot e shpjegon me shumë emocione andaj edhe ka gjuajtur. Në fund i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë asnjëherë vepër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme dhe se kjo ka qenë hera e parë që është përfshirë në ndonjë vepër penale.

Prokurori i shtetit, shprehu pajtimin për pranimin e fajësisë nga i pandehuri B. K., pasi që ky pranim është në përputhshmëri me dispozitat ligjore të KPP, i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit dhe me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e sinqertë të fajësisë nga i akuzuari t'a merr si rrethanë lehtësuese.

Pas deklarimit të të pandehurit se ndihet fajtor për kryerjen e veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK dhe, pas pajtimit të prokurori i shtetit, gjykata gjithashtu e aprovoi fajësinë nga i pandehuri, pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, dhe se ky pranim është bërë vullnetarisht dhe i mbështetur në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza.

Gjykata, pas aprovimit të fajësisë së të pandehurit për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK dhe vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmbanë akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë elementet e veprës penale që i vihet në barrë, të përshkruar si në nën pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi, andaj pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK dhe i shqiptoi dënim të paraparë ligjor, njëherësh armën e propozuar nga prokurori ia konfiskoi, siç precizohet në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Ndërsa sa i përket veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të

paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK nga pika II e dispozitivit të aktakuzës për të cilën tashmë prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja e mëtejme penale, gjykata refuzoi akuzën.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurit të lartshënuar, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit si, rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, gjendjen e dobët materiale, shprehjen e sinqertë të keqardhjes dhe pendimit për veprën e kryer, premtimin e dhënë se nuk do të përsërisë veprën tjetër penale, ndërsa rrethanë rënduese nuk gjeti, andaj në aplikim të dispozitave të zbutjes të njëjtë i shqiptoi dënim burgimi, të cilin dënim ia kushtëzoi për periudhë të caktuar verifikuese, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, se ky dënim do të ndikojë në risocializimin e të njëjtë, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe në fund, me bindje se i pandehuri në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngajshme.

Vendimin për konfiskimin e sendit, të armës dhe gjësendeve të tjera, të mbajtura, përkatësisht të përdorura në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 69 të KPRK lidhur me nenin 375 par.3 të KPRK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 dhe 363 par.1 pika 1.1 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.384/16, me datë 20.06.2017

Sekretarja juridike
Ardita Azemi

Kryetarja e trupit gjykues
Suzana Çerkini

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.